

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ankimoi dënimin me 1 vit burg, Salianji: Duan të më mbajë larg zgjedhjeve lokale, ja hapi i radhës
ADRESA	https://lajmifundit.al/ankimoi-denimin-me-1-vit-burg-salianji-duan-te-me-mbaje-larg-zgjedhjeve-lokale-ja-hapi-i-radhes-i1339095
BURIMI	lajmifundit.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 09:02:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 10:53:52 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	21f576bdf953a3df215a4809775e986b667a73e10784aa9c1c18d130370856f7
TEKSTI	7a735db245fe147999579ec2ca358423d0a3d9a73e2b853395b2289e3bdf4e5b
PAMJA	eba6634efeac97e892309704dd9c25ffd152a70cd13d6e3ecd3fdf527dd32b14

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4acf85ae9ee1e77cc4f8b26f06bd47e956f504fd24015f265792bdb4a7ad5cda
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5542c6f376d7530e05241a95b291e64e02f5f89d799222f37a26423635f8fe31
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4acf85ae9ee1e77cc4f8b26f06bd47e956f504fd24015f265792bdb4a7ad5cda>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Ankimoi dënimin me 1 vit burg, Salianji: Duan të më mbajë larg zgjedhjeve lokale, ja hapi i radhës

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Kapja e 22 ton dr'ogë, mediat e Ekuadorit: Mafia shqiptare tentoi të korruptonte agjentë të inteligjencës

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Tragjike, goditi kokën gjatë ndeshjes, ndërron jetë 16-vjeçari shqiptar në Greqi (EMRI)

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Ndezi zjarr për të djegur mbeturinat, flakët shkaktuan dëme të mëdha, pranga 31-vjeçarit në Fier

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Kompania që prodhoi vaksinat kundër koron'avirusit mbyll tri fabrikat e saj në Gjermani

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Ankimoi dënimin me 1 vit burg, Salianji: Duan të më mbajë larg zgjedhjeve lokale, ja hapi i radhës



LAJMI FUNDIT / 29 SEPTEMBER 2026, 10:53

Shpërndaje

POLITIKË



Ish-deputeti i PD-së, Ervin Salianji i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese ku ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Apelit që e dënoi me një vit burg. Në një reagim në rrjetet sociale, Salianji pretendon se vendimi për kërkesën e tij tashmë është marrë dhe lë të kuptohet se Gjykata Kushtetuese e ka rrëzuar kërkesën e tij.

Salianji shprehet se dënimi dhe procesi gjyqësor synojnë ta mbajnë larg zgjedhjeve lokale, ndërsa paralajmëron se, në rast të rrëzimit të kërkesës së tij, do t'i drejtohet Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

"Sot nuk duhet të ishte thjesht një seancë gjyqësore për një çështje timen. Do të duhej të ishte një moment prove për Gjykatën Kushtetuese. Do të duhej të ishte dita kur Kushtetuta të fliste më fort se pushteti i regjimit autokratik. Por, fatkeqësisht, dikush mbahet peng me dosje korrupsioni, dikush shantazhohet me regjistrime, dikush përballet me dosje si bashkëpunëtor i shërbimit dhe dikush me lidhje me grupe kriminale, si Xhafajt. Kjo nuk është drejtësi që ngrihet mbi politikën. Kjo është drejtësi që mbetet peng i politikës", shprehet Salianji.

LEXONI GJITHASHTU



Kapja e 22 ton dr'ogë, mediat e Ekuadorit: Mafia shqiptare tentoi të korruptonte agjentë të inteligjencës



Tragjike, goditi kokën gjatë ndeshjes, ndërron jetë 16-vjeçari shqiptar në Greqi (EMRI)

MOTI NE TIRANE

Tirana, Albania

POLITIKË

Ankimoi dënimin me 1 vit burg, Salianji: Duan të më mbajë larg zgjedhjeve lokale, ja hapi i radhës

POLITIKË

Skandali i SHISH-it/ Klosi: Sulme personale që godasin insititucionet në mënyrë të padrejtë...

TRENDING



Destinacioni sekret: Wizz Air sjell në TIA 150 influencues dhe gazetarë për të zbuluar Shqipërinë



Kryeministri Rama në New York: Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës, dëshmi e transformimit të Shqipërisë



Ndezi zjarr për të djegur mbeturinat, flakët shkaktuan dëme të mëdha, pranga 31-vjeçarit në Fier

"Por sot nuk mbyllet beteja. Sot hapet rruga për betejën në Strasburg. Atje do të çojmë të vërtetën e kësaj çështjeje dhe të gjithë atë që ka ndodhur", vijon ish-deputeti demokrat.

Ervin Salianji

Gjykata Kushtetuese nuk ngjitet dot në nivelin kushtetues! Nuk bëj dot teatër si shumë të tjerë! Vendimet në GJK merren shumë përpara se të mblidhen formalisht, me solemnitetin e rremë të një procedure që të gjithë e dinë si përfundon. Edhe vendimi i sotëm është marrë. Po jua komunikoj përpara.

Gjyqtarë të kësaj Gjykate e kanë mbajtur peng prej thujse dy vitesh këtë çështje, për të zvarritur ankimin në Gjykatën e Strasburgut e sot erdhi dita që nuk mban më! Unë nuk jam dënuar si kriminel, por si kundërshtar i regjimit, si denoncues i grupeve më të fuqishme kriminale dhe për të më shmangur nga betejat elektorale. Gjyqi i caktuar sot është po me këtë qëllim: të më mbajë larg zgjedhjeve lokale.

Sot nuk duhet të ishte thjesht një seancë gjyqësore për një çështje timen. Do të duhej të ishte një moment prove për Gjykatën Kushtetuese. Do të duhej të ishte dita kur Kushtetuta të fliste më fort se pushteti i regjimit autokratik. Por, fatkeqësisht, dikush mbahet peng me dosje korrupsioni, dikush shantazhohet me regjistrime, dikush përballet me dosje si bashkëpunëtor i shërbimit dhe dikush me lidhje me grupe kriminale, si Xhafajt.

Kjo nuk është drejtësi që ngrihet mbi politikën. Kjo është drejtësi që mbetet peng i politikës. Unë nuk kërkoj dhe nuk kam kërkuar privilegj. Nuk kërkoj trajtim të veçantë. Kam kërkuar vetëm atë që duhet të jetë themeli i çdo shteti demokratik: një gjykim të drejtë, të pavarur dhe larg çdo ndikimi politik.

Por dua ta them shumë qartë: unë nuk trembem e frikësohem, sepse nuk kam luftuar dhe nuk luftoj për privilegje. Luftoj për një Shqipëri të drejtë. Luftoj që ligji të jetë më i fortë se pushteti, që qytetari të jetë më i fortë se banda dhe që shteti të mos jetë pronë e askujt.

Luftoj për liritë dhe të drejtat e çdo shqiptari. Për një vend ku askush të mos dënohet sepse është kundërshtar politik, ku askush të mos shantazhohet për të heshtur dhe ku askush të mos ketë pushtetin të blejë, frikësojë apo përdorë drejtësinë.

Nuk do të ndalem! As burgun, as presionin, as ndalimi i kandidimit, as kërcënimet dhe as goditjet politike nuk më kanë ndaluar. Nuk do të më ndalin as sot, sepse beteja ime nuk është për një karrige.

Nuk është për një mandat. Nuk është për një privilegj por për të çmontuar sistemin që i ka dhënë pushtet bandave kriminale mbi shtetin, për t'i kthyer institucionet qytetarëve dhe për të ndërtuar një Shqipëri ku drejtësia nuk u shërben të fortëve, por mbron të drejtët.

Kam përballuar presionin, burgun dhe çdo goditje që më është bërë për shkak të bindjeve dhe qëndrimeve të mia politike.


Nuk jam tërhequr dhe nuk do të tërhiqem.

Por sot nuk gjykojem vetëm unë e prandaj po reagoj paraprakisht.

Gjykohet nëse në Shqipëri Gjykata Kushtetuese mund të kishte guximin minimal të ishte mbi autokracinë, por jo, regjimi dikton këta përrulen. Interesat e regjimit janë mbi kushtetutën dhe ligjin.

Unë e di se çfarë vendimi do të merret. Dhe pikërisht për këtë po e them përpara se të hapen dosjet, të mbyllen dyert dhe të lexohen disa rreshta që, nëse do të ishte ndryshe, do të duhej të lindnin nga ndërgjegjja e gjyqtarëve dhe jo nga pazaret e pushtetit.

Por sot nuk mbyllet beteja. Sot hapet rruga për betejën në Strasburg.



POLITIKË

A është i zhgënjyer nga politika? MC Kresha flet pa dorashka



POLITIKË

FOTOLAJM/ U komandua në krye të SHISH pas shkarkimit të Hysenit, Elvis Lila për herë të parë në publik

ME TE LEXUARAT

"Zbrazti karika'torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi" – Mediat italiane: Jeta e "dyfishtë" e...

[Lexo lajmin e plotë](#)

Euron pëson rënien si asnjëherë më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutor 23 shtator 2026

[Lexo lajmin e plotë](#)

Skandali "Xhaka" merr përmasa të tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë

[Lexo lajmin e plotë](#)

Zbulohet e vërteta për Bleona Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?!

[Lexo lajmin e plotë](#)

Ate do te çojme te verteten e kesaj çesnjeje dhe te gjitne ate qe ka naodur.

Nuk kam frikë dhe asnje emocion personal nga vendimi. Kam përballuar burgun dhe presionin politik. Nuk më tremb një tjetër goditje nga një sistem që prej kohësh ka treguar se sa larg është gati të shkojë për të goditur kundërshtarët. Do të vazhdoj të luftoj. Për liri. Për të drejta. Për drejtësi. Për një shtet që nuk ulet në gjunjë para krimit. Për një Shqipëri ku bandat nuk bëjnë ligjin dhe pushteti nuk është mbi ligjin.

Sot është akti i radhës ku Gjykata Kushtetuese tregon që është garanci e regjimit!

ME TE LEXUARAT

“Zbrazì karika'torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi” – Mediat italiane: Jeta e “dyfishtë” e Gjovalin Lazrit

[Lexo lajmin e plote](#)

NA SHKRUAJ

Portali Lajmifundit sjell Lajme nga Shqipëria, rajoni dhe bota në kohë rekord. Ju lutemi na kontaktoni nëse doni të kontribuoni me informacione të vlefshme për publikim në portalin tonë.

[Kliko për më shumë informacion](#)

Euron pëson rënien si asnjëherë më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutor 23 shtator 2026

[Lexo lajmin e plote](#)

Skandali “Xhaka” merr përmasa të tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë

[Lexo lajmin e plote](#)

Zbulohet e vërteta për Bleona Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?!

[Lexo lajmin e plote](#)

“Askush nuk është mbi ligjin”/ Rama shkarkon menjëherë Vlorë Hysenin: Pas kthimit në Tiranë zgjedh drejtuesin e ri të SHISH

[Lexo lajmin e plote](#)

Sekuestrohet hoteli “Central Park Premium” në Ksamil, u ndërtua pa leje! Ja kujt i përket

[Lexo lajmin e plote](#)

“Ka gjëra që edhe ne që i dimë nuk flasim dot”/ Artan Hoxha: Ka fakte tronditëse për Ballukun, gropa u hap

[Lexo lajmin e plote](#)

LAJMI FUNDIT   **KUSH JEMI** **KONTAKT REDAKSINË** **TE DHENAT PERSONALE** **COOKIES**

LajmiFundit merr pjesë në programe të ndryshme marketingu ku mund të përfitojë komisione për produktet e zgjedhura në artikujt e publikuar.

Created & Monetized by **Mediadesk**

REGJISTROHU NË NEWSLETTER

OK

Ju do te merrni njoftime periodike me Lajmet e Fundit.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.